

## ALBANOLOGU QË GJITHNJË SJELL BEFASI

Bisedë me albanologun e njohur, Robert Elsin

Bashkëbiseduesi ynë, Robert Elsi, është i lindur në Vankuver të Kanadasë, më 1950, kurse aktualisht jeton në Gjermani. Që nga viti 1979 ka filluar studimet në fushën e albanologjisë dhe deri më tash ka botuar rreth 15 vepra të rëndësishme nga kjo fushë.

Në bisedë për "Zërin" albanologu i njohur kanadez, z. Robert Elsie, pos tjerash tha se në Kosovë ka filluar një botë e re, në mos tërësisht e re, për jetën kulturore dhe atë politike. Kosova është një vend i ri në Europë, i sapolindur, në një situatë krejt të re në jetën e shkrimtarëve, të cilët do ta pasqyrojnë në krijimtarinë e tyre.

*Zëri: Cili është mendimi juaj për organizimin e Seminarit si dhe për programin e ligjeratave?*

Elsi: Unë jam i kënaqur që Seminari zhvillohet prapë në Prishtinë, ku ka pasur një ndërprerje të gjatë. Sivjet është një fillim i ri për Seminarin, për organizatorët, për pjesëmarrësit. Edhe pse ka njëfarë traditë, kanë kaluar shumë vite që nga fillimi. Unë mendoj se seminari prapë ka arritur sukses, edhe pse numri i pjesëmarrjes është më i vogël në krahasim me seminarët e viteve '80. Por, është ky një hap i parë dhe herën tjetër do të vijë njerëz më shumë, sigurisht.

*Zëri: A mund të thuhet se ky seminar është i standardeve shkencore të seminareve të kaluara?*

Elsi: Standardi është normal. Është ndoshta edhe më i lartë se herave të tjera, përveç se numri i pjesëmarrësve është më i vogël, veçmas nga vendet europiane, nga të cilat zakonisht vinin në numër më të madh.

*Zëri: Cili është mendimi juaj për programin e ligjeratave dhe për sesionin shkencor?*

Elsi: Unë mendoj që sesioni shkencor është tepër i ngarkuar, ka shumë ligjerata, kemi pak kohë dhe është vështirë të dëgjohen të gjitha. Është e natyrshme se me gjithë kufizimin kohor që u jepet ligjeruesve, prapë koha nuk mjafton dhe unë mendoj se ky sesion do të duhej të zgjaste tri ditë.

*Zëri: Me çka keni ardhur në këtë seminar?*

Elsi: Mendoj që kam një gjë shumë interesante, jo vetëm për shkencëtarët, por edhe për publikun e gjerë. Është fjala për inçizimin e parë të gjuhës shqipe, i cili është bërë nga profesor Norbert Jokl, albanolog i Vienës. Këtë inçizim e kam me vete dhe do ta paraqes në këtë sesion, si dhe për publikun e gjerë shqiptar, për herë të parë në histori. Inçizimi i zërit është i vitit 1914.

*Zëri: Ju keni botuar "Historinë e letërsisë shqiptare". Ç'gjëra të reja mund të presim nga kjo fushë?*

Elsi: Veprën "Historia e letërsisë shqiptare" e kam punuar në mes viteve 1988-1991, pra në kohën e transicionit dhe të përfundimit të diktaturës në Shqipëri dhe gjatë viteve të ndryshimeve të mëdha këtu në Kosovë. Kjo Histori e letërsisë përfshin letërsinë shqiptare që

nga fillimet e deri në vitin 1990. Natyrisht, kanë kaluar 10 vjet dhe ka shumë për të thënë për letërsinë e sotme, por kjo do të ishte për një vepër tjetër, ose për një studim tjetër, ose vepër të vogël, të qartë rreth letërsisë së sotme, ndoshta duhet pritur disa vjet...

*Zëri: Si është pritur ky libër nga njerëzit e shkencës mbi letërsinë, meqë bëhet fjalë për një studiues të huaj?*

Elsi: Këtu nuk është puna për kombësinë e shkruarit. Unë kam dëgjuar fjalë të mira për librin tim dhe shumë pak kritikë. Është vështirë të bëhen krahasime mes librit tim dhe të atij që ka bërë Akademia e Shkencave e Shqipërisë, i cili u botua në një diktaturë politike dhe kulturore që ka shtypur shkencëtarët dhe që nuk i ka lejuar të shkruajnë lirisht për letërsinë dhe kulturën, kështu që rezultati ishte mjaft i njëanshëm, i dobët, i kufizuar, nuk përmbush nevojat e lexuesit të sotëm. Dhe kështu lexuesi i sotëm ka në duar librin tim, nga i cili mund të mësojë. Nuk them se ky është libër i përkryer, por është e vërtetë se është i vetmi libër për historinë e letërsisë shqiptare që mund të lexohet sot.

*Zëri: Ju keni botuar edhe një libër "Evlija Çelebi në Shqipëri dhe vendet përreth..." Cilat probleme i trajton ky libër?*

Elsi: Ky libër është një përkthim anglisht i dorëshkrimit turk. Evlija Çelebi ishte një udhëtar turk i shek. XVII, i cili ka ardhur dy herë edhe në Shqipëri dhe një herë në Kosovë. Ai i përshkruan udhëtimet e tij me shumë hollësi, dhe për herë të parë kam përgatitur dorëshkrimin osmanisht bashkë me një turkolog nga SHBA dhe kam bërë një përkthim anglisht, të cilin e kemi botuar para tetë muajsh. Ky është një libër që jep shumë informacion për Shqipërinë, për kulturën shqiptare, për qytetet e Shqipërisë, p. sh. për xhamitë, kishat, rrugët, shkollat, njerëzit e Shqipërisë, besimin e shqiptarëve dhe pak për jetën intelektuale. Kush e lexon, do të habitet për kulturën e lartë që ka pasur në Shqipëri në shek. XVII. Kush lexon për Beratin apo për Elbasanin në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebisë dhe shkon në këto qytete sot, do të habitet. Ky libër do të mund të përkthehet shqip, nëse gjindet një botues.

*Zëri: Kemi informacione se keni gjetur një histori shqiptare të shek. XIX. Çka është kjo histori?*

Elsie: Unë kisha dëgjuar për burimet për një histori të Shqipërisë. Nuk mbaj mend kur, por dëgjova se kishte një dorëshkrim në Stamboll. Dhe shkova në Stamboll para katër vitesh dhe hulumtova nëpër arkivat dhe në fund bisedova me drejtorin e një liceu francez për të dhe ai më tha se po ky lice kishte pasur arkiva për Shqipërinë dhe se këto ishin bartur në Paris. Më dha emrin e një prifti francez. Unë i dërgova një letër priftit francez, me të cilën i kërkova këtë vepër dhe, pas një viti e gjysmë, në shkurt të këtij viti, mora një letër, në të cilën më bënte me dije se ai, ndërsa hulumtonte në këto arkiva, ka gjetur një dorëshkrim të historisë së Shqipërisë. Unë menjëherë shkova në Paris dhe e gjeta dorëshkrimin, i cili tamam ishte histori e Shqipërisë, e shkruar nga një prift francez me emrin Zhan Klod Faverial. Dorëshkrimi ka 433 faqe që përfshin gjithë historinë e Shqipërisë që nga koha e lashtë deri në kohën e autorit, fundi i shek. XIX. Faveriali vdiq më 1893 dhe kishte mbaruar dorëshkrimin për afërsisht diku më 1889. Kështu, kjo histori e Shqipërisë është historia e parë e shkruar ndonjëherë në të gjitha gjuhët e botës, dhe është një vepër që ka rëndësi historike dhe kulturore për Shqipërinë. Këtë libër, së pari, do ta botoj frëngjisht, pastaj do të mund të përkthehet në gjuhën shqipe.

*Zëri: Çka mendoni për njohjen e letërsisë shqipe në botë?*

Elsi: Letërsia shqiptare është fare e panjohur. Ka shumë pak botime, shumë pak përkthime. Problemi nuk është te mungesa e vlerave letrare të letërsisë shqipe, por problemi është se mungojnë përkthyes. Nuk do të thotë që çdo vepër e letërsisë shqiptare ka vlerë, do të thosha se shumica madje nuk kanë vlerë, por midis tyre ka disa xhevahirë që meritojnë të përkthehen. Mirëpo, problemi është që nuk ka përkthyes nga gjuha shqipe.

*Zëri: A keni ndonjë projekt të ri per hulumtime filologjike shqiptare?*

Elsi: Unë kam disa projekte, ndër të tjera edhe botimin e librit të Faverialit, pastaj memoaret e baron Nopçës, që i kam gjetur në një arkiv në Vienë. Memoaret e albanologut hungarez Franc Nopça do të botohen gjermanisht së pari, e pastaj, shpresoj, ndoshta edhe shqip, sepse janë me interes. Në tetor-nëntor të këtij viti do të botoj në Londër një vepër të madhe për besimin dhe kulturën popullore shqiptare, njëfarë fjalori, ku do të përfshij fenë shqiptare, vendet e shenjta, mitologjinë, figurat mitologjike, bestytnitë, kulturën popullore, siç janë zakonet e vdekjes, të lindjes etj. Kjo është një vepër e madhe dhe unë jam i bindur se ka shumë gjëra që nuk janë botuar kurrë më parë, dhe do të jenë me interes.

*Zëri: Ndryshimet shkencore nuk kanë arritur për shkak të mungesës së metodave të reja shkencore, apo është mënyra e shkollimit pasojë e këtij niveli të pakënaqshëm?*

Elsi: Ndoshta të dyja. Ka mungesa në çdo drejtim. Dhe më duket se edhe shkencëtarët janë në dijeni për problemet që kanë. Por, do të kapërcehen, sepse tani për herë të parë në historinë e Kosovës ky vend është i lirë dhe ka një qarkullim të lirë të njerëzve e të mendimeve. Gjithë bota ka ardhur në Prishtinë dhe kjo do t'i ketë pasojat e veta.

*Zëri: A keni ndonjë vlerësim për letërsinë e re shqipe të viteve '90?*

Elsi: Kam një ide. Unë i blej rregullisht të gjithë librat e rinj edhe në Prishtinë, edhe në Tiranë. Disa nga ato janë kot, por gjej edhe gjëra të bukura në disa prej tyre. Nuk kam një ide të qartë të zhvillimit. Nuk mund të them se letërsia shqipe shkon në një drejtim të caktuar. Ajo është e shpërndarë dhe shkon në njëqind drejtime. Duhet të presim ca kohë që të japim një vlerësim më të saktë.

Bisedoi: Adem Abazi.

[Botuar në gazetën: *Zëri*, Prishtinë, e shtunë, 26 gusht 2000, f. 16]